



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.532/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Milena Đerić dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lartë Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Hakif Berisha, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Podujevë, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Podujevë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të largimit nga lista e kandidatëve për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale 2021, si kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Podujevë në seancën e panelit të mbajtur me 27.08.2021, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si i palejueshëm apeli i evidentuar si Anr.532/2021 e datës 25.08.2021 i parashtruar nga Hakif Berisha, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të largimit nga lista e kandidatëve për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale 2021, si kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Podujevë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Podujevë.

A r s y e t i m

Parashtruesi i apelit Hakif Berisha, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Podujevë, nga radhët e subjektit politik PDK, me datën 25.08.2021 ka paraqitur një apel në PZAP, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me të cilin pretendon se nuk është pranuar si kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Podujevë për Zgjedhjet Lokale 2021, duke pretenduar se ai posedon dokumentin se rasti i tij nuk ka përfunduar ne gjykatë pasi qe ky rast është ne ankese.

Me datë 24.08.2021 PZAP, i ka paraqitur KQZ-së kërkesë për përgjigje duke kërkuar që të paraqesë përgjigje në ankesë deri me datë 25.08.2021 ora 12:00.

KQZ-ja, në përgjigjen në ankesë ka theksuar, se ka kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), që të bëjë verifikimin e kandidatëve që marrin pjesë në garë zgjedhore për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me 17 tetor 2021, nëse të njëjtit janë dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm nga Gjykatat e Republikës së Kosovës. Në këtë rast Hakif Berisha, kandidat për asamble komunale në Kuvendin Komunal në Podujevë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) nga të dhënat e pranuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në listën e Kandidatëve të subjektit politik PDK rezulton të jetë shpallur fajtor për vepër penale me vendim përfundimtar të gjykatës në tri (3) vitet e fundit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në përgjigjen e parashtruar ka sqaruar se subjektit politik PDK i ka kërkuar që kandidatin Hakif Berisha ta zëvendësoj me kandidatë tjerë.

Paneli, pas shqyrtimit të lejueshmërisë së apelit, gjeti se:

Apeli është i palejuar

Paneli, vlerësoi lejueshmërinë e apelit dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 122 të LZP-së dhe nenin 10 të Rregullës Nr. 02/2015- Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it.

Paneli, konstaton se pretendimet ankimore të Hakif Berishës, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Podujevë, nga radhët e subjektit politik PDK, lidhur me largimin nga lista e kandidatëve për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale që do të mbahen më 17 tetor 2021, nuk mund të jetë objekt i vlerësimit në këtë fazë të procesit zgjedhor, për faktin se, KQZ-ja ende nuk ka marrë vendim lidhur me certifikimin e listës së kandidatëve, ashtu siç del edhe nga vet përgjigja në ankesë e KQZ-së e parashtruar më datën 25.08.2021. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në përgjigjen e parashtruar ka sqaruar se subjektit politik PDK për kandidatin e caktuar si më lartë i është dhënë afat për zëvendësim me kandidatë të tjerë.

Kërkesa e ZRPPC-së, drejtuar subjekteve politike për zëvendësim të kandidateve të tyre nuk është vendim i KQZ-së, ndaj të cilit lejohet apeli, por është një kërkesë nga ZRPPC-ja, në lidhje me rastin në fjalë, ku subjektit është njoftuar se kandidati/ja në listën zgjedhore pas verifikimit nga ana e KGJK-së nuk është i përshtatshëm sipas Ligjit, dhe subjekti ka mundësi ta zëvendësoj me ndonjë kandidat tjetër brenda një periudhe të caktuar para se të rekomandohet nga zyra në fjale certifikimi apo mos certifikimi i listës së plote të kandidateve. Pra faza kur është parashtruar apeli është e parakohshme sepse nuk kemi vendimmarrje të KQZ-se për certifikim të subjektit dhe listës së tyre, por kemi vetëm zëvendësim nga subjekti të cilit i përket apeluesi, dhe se subjekti nuk është i obligueshëm të bëjë zëvendësimin e kandidatit nëse vlerëson se të gjithë kandidatët janë të përshtatshëm konform nenit 29 të LZP-së.

Meqenëse në rastin konkret nga ana e KQZ-së nuk është marrë vendim lidhur me këtë çështje juridike, paneli vlerëson se nuk është nën juridiksionin e këtij institucioni që në këtë fazë të procesit të vendosë lidhur me kërkesat e ZRPPC-së, ngase sipas nenit 122 par.1 pikat a), b), c), d), e) dhe f) të LZP-së, PZAP-i, vendos vetëm për vendime të KQZ-së, të cilat përfshihen shprehimisht në dispozitën e sipërshënuar.

Hudhja e ankesës së ankuesit në këtë fazë të procedurës, mbi këtë bazë nuk cenon të drejtën e ankuesit që pas certifikimit apo kundërshtimit për certifikim të kandidateve të subjekteve politike nga KQZ-ja, ta paraqes sërish ankesë, nëse konsideron se i është cenuar e drejta e pretenduar, edhe pas certifikimit nga KQZ-ja.

Andaj mbi këtë bazë Paneli vlerëson se apeli është i palejuar. Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me nenin 118 të LZP-së dhe nenin 11 paragrafi 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 532/2021 më datën 27.08.2021.

**Kryesues i Panelit
Faton Ademi**



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.